



| | |
|--|---------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO | KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN |
| 01 Nr. / Br. | 227/13 |
| Nr. i fq. / Br. st. | -10- |
| Data: / Datum | 27.09.2013 |
| VUSHTRRI - VUČITRN | |



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

P R O C E S V E R B A L
Nga mbledhja e X-të për vitin 2013, e Kuvendit Komunal në
Vushtri, mbajtur më 26.09.2013

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:13. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Abdullah Vojvoda, Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Esat Beka, Ergin Sunguri, Ferit Idrizi, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gérxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muhamrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gérxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shpëtim Zhegrova, Veli Karaça, Xhemajl Pllana, Vlora Qirezi dhe Zeqir Hasani.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkyetari i komunës, drejtori i drejtive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Debat lidhur me rendin e ditës:

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se nuk është hera e parë që e kemi ngritur çështjen e respektimit të Rregullores së Punës së Kuvendit, pasi që dërgimi i materialit për mbledhjen e sotme të KK-së ka ardhur me vonesë, kurse Rregullorja e Punës së Kuvendit kërkon që materiali të dërgohet 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së KK-së. Po ashtu tha se është shkelur e njëjta rregullore edhe në mbledhjen paraprake të KK-së, me ç'rast nuk iu është dhënë fjala për replikë. Gjithashtu rregullorja kërkon që çdo anëtar i kuvendit të komunës të bartë kartën e identifikimit në vend të dukshëm, por kjo nuk po praktikohet nga anëtarët e KK-së. Mandaj lidhur me web-faqen e komunës, tha se web-faqja e komunës duhet të jetë vazhdimi i freskuar me lajme dhe shtoi se rubrikat këndi i opozitës dhe shpenzimet e komunës nëpër periudha kohore nuk hapen fare. Në vazhdim tha se në web-faqen në fjalë është publikuar lajmi i bojkotimit nga LDK-ja të akademisë përkujtimore për vrasjen e Ahmet Krasniqit, por do të duhej të përmendej arsyetimi pse është bojkotuar. Mandaj duke iu referuar një lajmi tjetër të publikuar në web-faqen e komunës, tha se zëdhënësi i komunës nuk ka të drejtë të flet në vetën e parë. Në fund lidhur me Strategjinë për Komunikim, Informim dhe Përfshirjen e Qytetarëve në Vendimmarrje, tha se kjo strategji është aprovuar qe 5 muaj, por komuna akoma nuk ka bërë plan të veprimit për zbatimin e strategjisë në fjalë, dhe këtë e cilësoi dështim të komunës.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- pasi që gjendemi në prag të fushatës zgjedhore, kerkoi nga kryetari i komunës dhe nga qeveria lokale që të mos keqpërdoren veturat zyrtare të komunës përfushata zgjedhore, pasi që ato janë pronë e komunës. Po ashtu kerkoi që gjatë fushatës zgjedhore të mos keqpërdoret buxheti i komunës me shpenzime telefonike dhe me dreka, pasi që po ka keqpërdorime të tilla.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se nuk do të keqpërdoret në asnjë mënyrë buxheti i komunës gjatë fushatës zgjedhore dhe sqaroi se kryetari aktual i komunës do të jetë në detyrë deri në përbërjen e re të kuvendit të komunës dhe deri pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve lokale. Në fund tha se Grupi kuvendar i PDK-së kérkon një fushatë të qetë zgjedhore dhe dinjitoze përfshirë gjithë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- falënderoi të gjithë anëtarët e KK-së përfundon kontributin dhe punën konstruktive, duke iu dëshiruar të gjitha të mirat.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se ka disa herë që ka ngritur problemin e rregullimit të rrugës e cila lidh fshatrat e Artakollit që nga pompa e benzinës në Bukosh dhe vazhdon e lidhet edhe me Obiliq, duke shtuar se edhe pse nuk është kompetencë e komunës, komuna e ka obligim që të interesohet përfshirë këtë rrugë në qarqet qeveritare, pasi që përfshirë çdo ditë në atë rrugë kalojnë me mijëra vetura, dhe e njëjtë është shumë e dëmtuar. Në fund kerkoi që kryetari i komunës dhe drejtori i infrastrukturës që këtë problem ta ngritin në qarqet qeveritare në mënyrë që të gjendet zgjidhje sa më e shpejtë.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se qe tri herë radhazi ka kerkuar informatë, por nuk ka marrë asnjë të tillë, prandaj e ripërsëriti kërkuesin përfundon mandatin i zhgënjer.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- falënderoi përfundon legjislativin dhe ekzekutivin, pasi që bashkërisht kemi kryer shumë punë të rëndësishme në të gjitha fushat përfshirë mirën e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Në fund tha se është e gatshme lista e investimeve kapitale të realizuara sipas vendbanimeve dhe çdo anëtar i kuvendit mund ta ketë një kopje.

Në përfundim të diskutimeve rrëth rendit të ditës, kuvendi me vota unanim miratoi këtë:

R E N D D I T E

1. **Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**
2. **Shqyrtimi i Draft-rregullores përfshirë Tatimin në Pronën e Paluajtshme përfundon vitin 2014 (shqyrtimi i dytë).**
3. **Shqyrtimi i Draft-strategjisë përfshirë zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë përfundon vitet 2013/2018 (shqyrtimi i dytë).**
4. **Shqyrtimi i Draft-buxhetit përfundon vitin 2014 (shqyrtimi i dytë).**
5. **Shqyrtimi i Informatës përfundimin e vitit shkollor 2012/2013 dhe përgatitjet përfundon shkollor 2013/2014.**
6. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit përfshirë ridestinimin e mjeteve të lira buxhetore përfundon shkollor 2013/2014.**
7. **Të ndryshme.**

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- kerkoi që diskutimi i tij të riformulohet me këtë përbajtje: "lidhur me eksplotimin e thëngjillit, tha se në vitin e kaluar është vepruar në mënyrë ilegale, sepse kompanitë nuk kanë pasur licencë nga KPMM-ja përfshirë zhvillimin e projekteve që janë në procedurë e sipër."

komunës dhe drejtorin e DA-së se në vitin e kaluar a janë furnizuar shkollat me thëngjill të kontrabanduar dhe me cilësi shumë të dobët, por për habi nga asnjeri nuk ka marrë përgjigje adekuate".

Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, me vërejtjen e Xh. Pllanës.

2. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2014 (shqyrtimi i dytë).

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se nuk është inkorporuar asnjë vërejtje që kanë dhënë anëtarët e kuvendit gjatë shqyrtimit të parë, prandaj te neni 6 te normat e tatimit në përqindje kérkoi që të merren parasysh vërejtjet e paraqitura, pasi që prona rezidenciale banesa dhe shtëpia nuk mund të tatimohen njësoj sikur prona e pameremetuar dhe garazhet, si dhe prona e braktisur. Pastaj te neni 5 baza e tatimit, tha se pasi që në bazë të ligjit baza e tatimit në pronë është vlera e pronës në treg, atëherë lidhur me përbajtjen e pikës 5.2, kérkoi nga kryetari i komunës që komisioni për rivlerësim të pronave, për çdo vit kalendarik ta bëjë rivlerësimin e pronave.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, tha se hartuesi dhe propozuesi janë thirr në dispozita të statutit që nuk e rregullojnë këtë çështje. Pastaj në faqe nr. 5 te zonat, për zonën e dytë kérkoi sqarim për fjalinë: "në rrugën "Dëshmorët e Kombit" në të dy anët e rrugës deri te kyçja në magjistrale", prandaj kérkoi që të përcaktohet se për cilën rrugë është fjala.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2014, duke inkorporuar disa nga vërejtjet e anëtarëve të KK-së.

3. Shqyrtimi i Draft-strategjisë për zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2013/2018 (shqyrtimi i dytë).

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-strategjisë në fjalë, tha se kjo draft-strategji nuk i plotëson konditat çfarë do të duhej të ishte një draft-strategji për zhvillimin e komunës sonë për 5-vjeçarin e ardhshëm, duke shtuar se draft-strategjia në fjalë është sipërfaqësore, pasi që nuk është e thelluar në probleme konkrete dhe nuk iu jep zgjidhje problemeve konkrete. Prandaj kérkoi që ekzekutivi i komunës në bashkëpunim me hartuesin e kësaj draft-strategjie ta ripunojnë edhe njëherë këtë draft-strategji, duke i dhënë rrugëzgjidhje secilit problem që ka të bëjë me draft-strategjinë, sepse draft-strategjitet gjithmonë japid sqarime konkrete dhe ide për zhvillimin ekonomik të komunës dhe për këtë arsyet idetë duhet të jenë konkrete edhe me projekte, duke precizuar për secilin rast projekte konkrete.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të LDK-së tha se draft-strategjia në fjalë përshkruhet nga një narrativ i mirë, por është një përshkrim sipërfaqësor dhe teorik dhe nuk është konkrete, prandaj përmendi këto vërejtje: duke filluar nga profili i komunës, ku epiqendra e profilit do të duhej të ishte profili ekonomik, e jo përshkrim fjalësh për të krijuar një shumësi të faqeve, ashtu siç është edhe te korniza afatmesme e shpenzimeve, po ashtu organogrami i komunës nuk ka nevojë të jetë fare, sepse i njëjti mund të ndërrohet për çdo vit. Pastaj lidhur me analizën SWOT, tek përparësitë, ku thuhet se "përparësi është sipërfaqja e mjaftueshme e tokës" dhe këtë fjali e vlerësoi qesharake, sepse kemi mungesë të madhe të tokës, për këtë arsyet kérkoi që kjo fjali të hiqet. Po ashtu tek përparësitë mungon toka nën masat komasative, duke shtuar se është një përparësi e madhe për komunën tonë për zhvillimin e bujqësisë. Pastaj tek përparësitë duhet të shënohet prodhimi i farës cilësore të patates

në Komunën e Vushtrrisë, pasi që Komuna e Vushtrrisë prodhon farën cilësore të patates. Ndërsa tek rreziqet, tha se nuk është përmend rreziku kryesor i ekonomisë së komunës, dhe rreziqet tjera siç janë: korruzioni i pranishëm në komunë; nepotizmi; moszbatimi i ligjit; mungesa e ujit të pijshëm dhe atij industrial, si dhe mungesa e energjisë elektrike. Kurse tek dobësitë, tha se dobësi është që janë hequr elementet e lashtësisë së qytetit, siç janë kubëzat, ndërsa dobësi tjera janë: investimet në infrastrukturë nuk bëhen sipas prioriteteve, prandaj është dashtë të përmendet tek dobësitë, po ashtu dobësi e madhe është mungesa e investitorëve në komunën tonë. Tek vizioni, tha se vizioni përsëri ka mbetur përshkruar dhe nuk e parashev ardhmérinë, dhe i njëjtë është i gjatë dhe joprofesional, prandaj një vizion i paraqitur në këtë mënyrë nuk duhet të jetë në këtë draft-strategji. Në vazhdim tek burimet natyrore, tha se përshkruhen burimet natyrore, por nuk ka asnjë rekomandim se si të shfrytëzohen të njëjtat, si dhe nuk ka asnjë projekt se si të bëhet promovimi i burimeve para investitorëve të mundshëm, prandaj draft-strategjisë në fjalë i mungon aspekti praktik, sepse në aneks të strategjisë duhet të përfshihen projektet konkrete të përcaktuara me kosto dhe në kohë, pasi që shtoi se në draft-strategji janë paraqitur disa tabela, por është për keqardhje nëse konsiderohet se ato janë projekte. Në fund tha se Grupi kuvendar i LDK-së nuk e voton këtë draft-strategji, pasi që për të njëjtën kërkon rishqyrtim dhe përmirësim, sepse ka të meta të mëdha.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-strategjinë në fjalë, tha se nuk është pozitive shpejtësia e aprovimit të dokumentit të tillë, pa pjesëmarrjen e shumë akterëve që duhet të janë prezant, pasi që strategja në fjalë e ka domethënien për zhvillimin e komunës në 5 vjeçarin e ardhshëm. Pastaj tha se nëse bëhet krahasim në mes të strategjisë dhe kornizës afatmesme buxhetore e cila përcakton kufijtë se nga mund të shkohet në aspektin buxhetor, atëherë strategjia në fjalë më tepër i përngjan dëshirave të caktuara dhe vullnetit të mirë, por jo edhe mbulesës financiare, pasi që ka disproporcione të madh në mes të dëshirave të paraqitura dhe mundësive buxhetore. Pastaj tha se me këtë strategji nuk ka një gjenerim të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të komunës sonë, pasi që mjetet janë orientuar vetëm kah sfera e asfaltimit, por ekonomisë duhet t'i jepet zhvillimi i duhur duke hapur vende të punës dhe krijimit të ambientit të mirëfilltë. Në vazhdim tha se nëse në vitin 2014 në strategji janë 169.000 € në bujqësi, në KAB janë 139.000 €, në vitin 2015 në strategji janë 176.000 €, kurse në KAB janë 100.000 €, në 2016 në strategji janë 203.700 €, në KAB janë 100.000 €. Mandej tha se nëse flitet për planet e arsimit, për vitin 2014 në KAB janë 97.612 €, kurse në strategji janë 847.412 €, për vitin 2015 në KAB janë 109.000 €, kurse në strategji janë 911.000 €, prandaj kjo çështje do të duhej të kishte një harmonizim në mes të gjitha këtyre formave dhe mundësive reale. Në fund në emër të Grupit kuvendar të AAK-së tha se kjo draft-strategji paraqet një akumulim të dëshirave, mirëpo është obligim që para qytetarëve të jemi realistë në parashikim dhe në parametra të përcaktimit të zhvillimit lokal ekonomik të komunës sonë, prandaj kérkoi që kjo draft-strategji edhe njëherë të rishqyrtohet dhe analizohet.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- tha se strategja është një nevojë e kohës dhe domosdo, por draft-strategjia në fjalë ka gabime edhe gjuhësore, por edhe në shumë vende terminologjia shqipe futet në kllapa, kurse terminologjia angleze është prioritare. Pastaj te shrirja gjeografike, thuhet se Vushtrria shtrihet në pjesën veriore dhe veriperëndimore, kurse duhet të thuhet se Vushtrria shtrihet në pjesën veriore të Republikës së Kosovës dhe të rrafshit të Kosovës. Po ashtu ka kontradikta te numri i komiteteve, pasi që diku thuhet se janë dy komitete të përhershme, diku thuhet se janë katër komitete të përhershme, kurse për komitetet konsultative, diku thuhet se janë pesë komitete e diku thuhet se janë gjashtë komitete, prandaj duhet të korrigohen. Mandej tha se tërësia gjeografike është paraqitur në mënyrë konfuze, pasi që nuk thuhet se a është gjatësia gjeografike lindore, apo gjerësia gjeografike veriore. Gjithashtu tha se numri prej 16.000 të punësuarve nuk është i argumentuar, kurse përsëritet fjalia "kjo rini e fuqishme", duke shtuar se është një refren i panevojshëm. Ndërsa nuk mjafton të

thuhet se do tē bëjmë bazën ligjore, por duhet thënë se do tē angazhohemi pér zbatueshmérinë e bazës ligjore. Po ashtu ka kontradikta në mes tē tē punësuarve në shëndetësi, pasi që diku thuhet 205 e diku tjetër thuhet 222, prandaj është e nevojshme që tē përmirësohen këto gabime. Tek rrugët, diku thuhet se ka 325 kilometra rrugë lokale, 90 % e vendbanimeve kanë qasje në asfalt, kurse më poshtë thuhet se 22 vendbanime ose 33 % e vendbanimeve janë me asfalt, ose 45 % vendbanime apo 67 % tē vendbanimeve janë me rrugë tē asfaltuara. Pastaj thuhet furnizimi me ujë përfshin 24 vendbanime ose 36 % tē vendbanimeve. Në vazhdim tha se nuk është potencial njerëzor vetëm rinia, sepse është potenciali kryesor, por nuk është i vetmi. Tek drejtimi strategjik thuhet moskompromentimi i ambientit, por shtoi se nuk është formulim i qëlluar, sepse duhet tē thuhet ruajtja ose mbikëqyrja e ambientit. Po ashtu thuhet shfrytëzimi i vargmaleve të Qyçavicës dhe Shalës, dhe shtoi se këto nuk janë vargmale, por janë male. Tek urbanizmi thuhet asfaltimi i rrugës magjistrale Nadakoc-Smrekonicë, por shtoi se nuk ka njohuri a është kompetencë e pushtetit lokal. Në fund duke iu referuar asfaltimit të rrugës "Dëshmorët e Kombit", tha se nëse veprohet kështu, atëherë do tē ishte gabim i madh dhe do tē bëhet shëmtimi më i madh i qytetit të Vushtrrisë.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- tha se draft-strategjia në fjalë dhe puna që është bërë meriton respekt, por nuk ka ardhur deri tek konkretizimi dhe përmendi dy segmente, ku në segmentin e parë thuhet mungesa e udhëzimeve të protokolleve dhe doracakëve standarde të operimit nëpër salla, dhe shtoi se kompetenca e nivelit primar është në komunë, kurse niveli sekondar është i ministrisë, kurse çështja e dytë ka të bëjë me referimin që bëhet nga niveli primar në nivelin sekondar, kërkoi që tē deshifrohet, pasi që nuk është kompetencë e komunës që në nivelin strategjik ta bëjë një rivlerësim të tillë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-strategjisë në fjalë, ku thuhet se pas vitit 1945 në Kosovë është vendosur administrata e pushtetit komunist, por duhet tē thuhet se është vendosur administrata ushtarake fashiste. Pastaj lidhur me çështjen e inflacionit, tha se ekonomistët vlerësojnë se inflacioni tek ne ka arritur shkallën 30 %, kurse në strategji ka dal 1.3 në vitin 2014, prandaj ky është një iluzion i tepruar, ndërsa tek numri i nxënësve ku thuhet se janë 17.000, sëqaroi se aktualisht kemi mbi 16.000 nxënës. Po ashtu përmendi çështjen e profilimit të degëve të arsimit, duke shtuar se drejtimet e degëve jemi duke i dhënë gabimisht, pasi që po shkohet kah krijimi i tepricave të kuadrove vetëm pér fotele, kurse në botë iu jepet rëndësi e madhe shkollave profesionale dhe teknike, prandaj përmes kësaj strategjie duhet t'i kushtohet rëndësi më e madhe shkollave profesionale dhe teknike. Në fund tha se kësaj draft-strategjie duhet t'i bëhen disa korrigjime, në mënyrë që tē del e plotë dhe e pranueshme.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-strategjisë në fjalë, tha se përt' u hartuar një strategji e cila do tē jetë e kapshme, së pari duhet tē harmonizohen dokumentet buxhetore që i parashev ministria dhe komuna, prandaj harmonizimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore me draft-buxhetin do ta përcaktojë shkallën e zhvillimit të komunës e cila është e bazuar në strategjinë e zhvillimit ekonomik. Pastaj tha se strategjia do tē na tregojë se ku do tē gjendet Komuna e Vushtrrisë me zhvillim në vitin 2018. Në vazhdim lidhur me hartimin e draft-strategjisë në fjalë, pyeti sesa do tē jetë numri i tē punësuarve në vitin 2018, si dhe shtoi se pasi që Korniza Afatmesme Buxhetore dhe draft-buxheti janë tē caktuara, pyeti se a janë identifikuar burimet e tē hyrave përmes të cilave do tē rritet zhvillimi ekonomik i Komunës së Vushtrrisë, apo a është paraparë që përmes projekteve konkrete të zbutet papunësia në vitin 2018 në Komunën e Vushtrrisë, sepse çdo qytetar i Komunës së Vushtrrisë e din se duhet tē jenë më të mira: shëndetësia dhe arsimi, kurse punësimi duhet tē jetë më i madh, pasi që nëse me strategji nuk parashihet një shëndetësi kualitative dhe një arsim cilësor, atëherë nuk mund tē ketë një zhvillim ekonomik tē mirëfilltë. Gjithashtu lidhur me projektet që janë paraparë me strategjinë e zhvillimit ekonomik, tha se është një dis-

harmoni e madhe në mes të shifrave të paraqitura, dhe përmendi si shembull se në vitin 2015 strategjia ka paraparë investime kapitale në shëndetësi 650.000 €, kurse komuna i ka vetëm 285.000 €, prandaj këtu është e nevojshme që strategjia t'i zbulojë burimet e mjeteve përmes të cilave do të mund të rriten të hyrat vatanake, që përmes të hyrave vatanake të mund të realizohen këto projekte në shëndetësi, arsim dhe në sferat tjera. Në fund tha se është mangësi mossubvencionimi i bujqësisë, sepse bujqësia në Komunën e Vushtrrisë është shtyllë e zhvillimit ekonomik dhe e punësimit, kurse shuma e paraparë e të hollave për këtë sektor është e vogël.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se draft-strategjia në fjalë është projekt i komunës i paraparë nga viti i kaluar për këtë vit, dhe kjo strategji është hartuar për qeverinë e ardhshme lokale. Pastaj tha se me këtë strategji janë përcaktuar kahet themelore të zhvillimit ekonomik të komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota “për”, 16 “kundër” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Strategjia për Zhvillimin Ekonomik të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2013/2018, duke inkorporuar vërejtjet e anëtarëve të KK-së.

4. Shqyrtimi i Draft-buxhetit për vitin 2014 (shqyrtimi i dytë).

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se nga draft-buxheti në fjalë janë hequr disa projekte, të cilat kanë qenë të propozuara më parë dhe përmendi rrugën prej varrezave të qytetit deri tek lagjja “Sfarqa dhe Rashica”, pasi që ka qenë e planifikuar për vitin 2014, pse është hequr, dhe shtoi se nuk është mirë që qeveria lokale të bëjë dallime në bazë të rajoneve aty ku ka vota pushteti aktual, prandaj në emër të grupit kuvendar të AAK-së propozoi që rruga në fjalë të hyjë në planifikim për realizim gjatë vitit 2014.

Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit- tha se që nga viti 2012 vazhdimisht ka kërkuar që të futet në prioritet një rrugë, pasi që janë mbi 50 familje që udhëtojnë nëpër baltë, prandaj kërkoi që me rishikim të buxhetit të ceket emërtimi i saj “rruga te KFOR-i”, dhe e njëjta të futet në prioritet për vitin 2014.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-buxhetin në fjalë, tha se ky draft-buxhet nuk përkon as 20 % me planin strategjik dhe me këtë projekt-buxhet nuk inicohen as kahet themelore të orientimit strategjik të planit strategjik (që u aprovua pak më parë), përveç disa rrugëve të asfaltuara, të cilat ndikojnë në zhvillimin e bizneseve dhe në priorititet e zhvillimit strategjik, pjesa dërrmuese e projekteve tjera nuk janë kompatibile në planin strategjik, prandaj pasi që draft-buxheti nuk përkon me planin strategjik dhe nuk ka një investim të balancuar të projekteve, Grupi kuvendar i LDK-së nuk do ta votojë.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-buxhetin në fjalë, tha se nuk janë zbatuar kriteret për zgjedhjen e prioriteteve, dhe projektet e paraqitura i plotësojnë nevojat e një pjese të qytetarëve, por nuk ka gjithëpërfshirje edhe pse këto projekte financohen nga buxheti i të gjithë qytetarëve. Pastaj tha se është befasuese që as në 5-vjetorin e ardhshëm nuk është planifikuar ndërtimi i një shkolle në fshatin Karaçë, duke shtuar se nuk ka njoħuri se a ka ndonjë fshat tjetër përveç Karaçës që nuk ka shkollë.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, paraqiti vërejtjet e tij tek shëndetësia dhe mirëqenia sociale pasi që nuk ka specifikim të mirëfilltë. Po ashtu tha se nuk është bërë korrektimi që kemi paraqitur vërejtjet në KPF. Mandej tha se ambulancat në Samadrexhë dhe në Duboc janë në kontejner, të ndërtohen, duke shtuar se figuron i njëjti raport sikur përpara, sikur tash. Në fund tha se në shumë takime për dëgjime buxhetore ka shtruar çështjen e rregullimit të Kullës së Begut në Balinc, si relikt historik që është dashtë të kryhet në rastin e shënimit të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, por e njëjta nuk figuron fare.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-buxhetin në fjalë, tha se është obligim i kuvendit të komunës pasi që taksat janë të qytetarëve që të ketë një trajtim të

barabartë dhe harmonik të zhvillimit të komunës dhe të përcaktimit të projekteve, prandaj kërroi trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët, pa dallime partiake. Në fund tha se nëse është njoftuar një komunitet i caktuar se do të hyjë në prioritet për vitin 2013 apo 2014, dhe nuk ka hyrë në asnjërin vit, atëherë Grupi kuvendar i AAK-së nuk do ta përkrah draft-buxhetin në fjalë.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- tha se risi në draft-buxhetin për vitin 2014 është përcaktimi i kufijve nëpër të gjitha kategoritë ekonomike, nga kjo nënkuptohet se me këto kufizime ministria ka propozuar që shpenzimet kapitale të shkojnë në rritje, kurse shpenzimet përmallra dhe shërbime të ulen aty ku ka mundësi të ulen. Mandej kërroi që me këtë draft-buxhet të intervenohet në rritjen e shpenzimeve kapitale te Sektori i bujqësisë, duke propozuar që të merren edhe 100.000 € nga të hyrat vetanake në mënyrë që të rritet fondi për Sektorin e bujqësisë. Po ashtu tek arsimi, tek investimet kapitale është një shumë e vogël e mjeteve, prandaj shumën prej 10.000 € për meremetimin e shkollave e propozoi që të rritet, pasi që është shumë e vogël për meremetimin e tyre. Në fund kërroi që mjetet e qytetarëve të orientohen aty ku është e nevojshme, duke u bazuar në prioritete.

Qamil Sahiti, drejtor i DKRS-së- njoftoi se në javën e ardhshme fillon intervenimi në Kullën e Zejnnullah Begut në fshatin Balinc.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi kuvendar i PDK-së e përkrah draft-buxhetin në fjalë. Po ashtu e përkrahu propozimin e anëtarit të KK-së nga PD-ja që ta ketë emërtimin e vet rruga Maxhunaj-Vilanc.

Safet Idrizi, drejtor i DSHPS-së- paraqiti sqarime shtesë lidhur me projektet kapitale përmalldesor shëndetësor.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- propozoi që në këtë draft-buxhet të hyjë edhe renovimi i shkollës "Bahri Kuqi" në Shtruherë, si dhe rregullimi i rrugës prej magjistrales te Unikonsumi e deri tek familja Ferati.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tha se mjetet më të mëdha në investimet kapitale përmalldesor janë realizimin e projekteve ka pas më pak mjete në raport me vitet e kaluara. Pastaj tha se janë realizuar shumë projekte në qytet dhe nëpër fshatra të Komunës së Vushtrrisë pa bërë dallime partiake. Në fund tha se fondi i bujqësisë është 3-4 herë më i madh sesa ai i vitit të kaluar dhe shtoi se përmallja janë ndarë mjete aq sa ka kërkuar Drejtoria përmalldesor Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-buxhetin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për", 7 "kundër", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare përmalldesor për vitin 2014, konform Qarkores Buxhetore 2014/02 të MEF-it, dt. 16.07.2013.

Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë përmalldesor për vitin 2014 është 13,419,233.00 €, prej të cilave përmalldesor:

| | |
|---|-------------------------|
| • Paga..... | 7,310,541.00 €. |
| • Mallra dhe shërbime..... | 1,365,862.00 €. |
| • Komunalitë..... | 248,360.00 €. |
| • Subvencione..... | 266,375.00 €. |
| • Shpenzime kapitale..... | 4,228,095.00 €. |
| Githsej:..... | 13,419,233.00 €. |
| Të hyrat vetanake të planifikuara..... | 1,652,000.00 €. |

5. Shqyrtimi i Informatës përfundimin e vitit shkollor 2012/2013 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2013/2014.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së tha se kjo informatë është e mangët dhe ka munguar kreativiteti në përgatitjen e kësaj informate nga ana e drejtorit të arsimit, sepse në këtë informatë do të duhej të ketë të dhëna më të sakta në lidhje me suksesin e shkollave sipas kategorive. Pastaj paraqiti shqetësimin për kalueshmërinë e ultë në klasat e VI-ta, kurse lidhur me përbajtjen e të dhënavë tek "suksesi i nxënësve në procesin mësimor" kur flitet për ngritjen e suksesit pozitiv të nxënësve, tha se është dashtë të bëhet krahasimi edhe me vitin e kaluar shkollor. Në vazhdim tha se ka qenë e nevojshme që të bëhet kategorizimi i shkollave sipas sukseseve të arritura. Po ashtu është dashtë të paraqitet në informatën në fjalë se cili ka qenë mësimdhënësi më i suksesshëm gjatë këtij viti shkollor. Mandej është dashtë të ceket në informatë se cili ka qenë nxënësi me rezultatet më të mira gjatë këtij viti shkollor. Gjithashtu në këtë informatë është dashtë të ceket numri i mësimdhënësve që janë pensionuar gjatë këtij viti shkollor, si dhe a është plotësuar vendi i tyre me kuadër adekuat profesional. Tutje tha se në shkollën SHMU-II- edhe pse objekti është i ri, ka pas klasa të mykosura dhe ky problem nuk është përmendur fare në këtë informatë, pasi që ka pas raste që janë sëmurë nxënës nga ky myk, ashtu siç do të duhej të kishte të dhëna rreth furnizimit me ujë në shkolla, si dhe çështja e ngrohjes në shkolla. Në fund tha se në informatë është dashtë të përmendet se në shumë shkolla mungojnë depot për depozitim e lëndëve djegëse.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë, tha se po bëhet një muaj që është prerë shiriti i shkollës, por ende nuk ka filluar puna në ndërtesën e re të gjimnazit "Eqrem Çabej", prandaj pyeti se kur do të fillojë së funksionuari objekti i ri i gjimnazit dhe cilat janë shkaqet që ende nuk ka filluar puna në këtë objekt të ri. Pastaj ngriti çështjen e suksesit të maturantëve, pasi që në informatën e kaluar shkolla e mesme teknike dhe ajo profesionale kanë pasur një kalueshmëri të ulët rreth 30-40 %, kurse tash kalueshmëria arrin mbi 80 %, prandaj pyeti se sa është valid ky sukses, kur dihet se po të njëjtët nxënës janë provuar në afatin e qershori dhe po të njëjtët në afatin e gushtit. Pastaj tha se problem tjetër është se për çdo ditë në shkollat tona ka importim të kuadrove nga qytetet tjera, edhe pse komuna jonë ka një potencial të fuqishëm intelektual që i plotëson vendet e punës, pa pasur nevojë për importim të kuadrove nga qytetet tjera, duke shtuar se komuna jonë ka kuadro edhe për lëndët deficitare, e lëre më për disa lëndë që nuk janë deficitare. Në fund tha se godina e re e gjimnazit i plotëson kushtet që të pajiset me laboratorë, pasi që ndikojnë pozitivisht në cilësinë e mësimit.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se informata në fjalë është e mangët dhe me të dhëna jo të sakta, pa analiza dhe komente për problemet që preokupojnë arsimin në Vushtrri. Pastaj tha se ligji nuk thotë që të përvirohet objekti i ri i gjimnazit ende pa përfunduar; ligji nuk thotë që shumica e shkolla nuk e kanë të siguruar ujin e pijshëm; ligji nuk thotë që duhet refuzuar konkurrentët e kualifikuar (me master) për mësimdhënie e të merren në punë të pakualifikuarit, duke shtuar se 11 mësimdhënës të pakualifikuar punojnë në shkollën e mesme profesionale, 27 mësimdhënës të pakualifikuar punojnë në shkollën e mesme teknike, 15 mësimdhënës të pakualifikuar punojnë në gjimnazin "Eqrem Çabej", në arsimin e mesëm të ulët dhe së bashku me shkollat e mesme të larta janë 106 punëtorë që punojnë, por që nuk kanë kualifikime adekuate, prandaj është për t'u çuditur që refuzohen kandidatët e kualifikuar për lëndën e gjuhës angleze dhe pranohen të pakualifikuarit. Mandej tha se është absurde që Drejtoria për Arsim i ka pranuar mbi 20 punëtorë pa konkurs, pa intervistë dhe pa kontratë. Po ashtu bëhen pranimet e drejtorëve të shkollave, të cilët nuk kanë fare trajnime, si dhe janë të pakualifikuar, duke shtuar se ka edhe ushtrues detyre të drejtorit që 5-6 vjet, kurse ligji e lejon 3-6 muaj. Ndërsa pyeti se a është real ky sukses i

nxënësve, ku kanë dalë përqindjet gati 100 %, pasi që rezultatet paraprake kanë qenë nën mesatare, prandaj shtoi se ka fryrje artificiale e cila e dëmton cilësinë e arsimit. Në fund tha se sa i përket regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të janë bërë gabime, pasi që nuk është analizuar profilizimi i drejtimeve, sepse shumica e nxënësve tentojnë që të regjistrohen në gjimnaz. Në fund sa i përket furnizimit me lëndë djegëse, tha se ka një disproporcional, pasi që çmimi i metrit të drurit është shumë i lartë prej 38 euro, po ashtu 29 euro kushton kubi i thëngjillit.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, e përshëndeti drejtorin e Drejtorisë për Arsim dhe stafin e tij për punën e bërë dhe sukseset e arritura. Po ashtu falënderoi të gjithë mësimdhënësit, drejtorët dhe nxënësit për sukseset që kanë arritur në vitin 2012/2013.

Qerim Selimi, drejtor i DA-së- duke iu referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit të komunës lidhur me informatën në fjalë, informoi se asnje punëtorë në arsim nuk është pranuar pa konkurs, si dhe asnje nxënës nuk është pranuar pa kriter në gjimnaz, kurse në vazhdim paraqiti sqarime tjera shtesë.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira buxhetore për plotësimin e projekteve që janë në procedurë e sipër.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- përmendi se më herët është propozuar ndërtimi i një ure mbrojtëse në rrugën që çon tek varrezat e qytetit në fshatin Begaj, duke shtuar se në këto raste është shumë me rëndësi që të gjendet ndonjë prioritet që i shërben mbrojtjes së qytetarëve.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ridestinohen mjetet nga:

Fondi 21, nga kategoria e investimeve kapitale (programi 664470, Drejtoria për Bujqësi), kodi i projektit 88500, ngritja e serrave në vlerë prej 30,000.00 €, dhe nga ky projekt shuma e mjeteve të lira buxhetore 2,723.50 € ridestinohen në projektin e ri: Pajisje e furrës me plin-gaz për shoqatën "Martirët e lirisë" në Vushtrri.

Fondi 10 Granti qeveritar mallra dhe shërbime në Drejtorinë për Shërbime Publike, shuma e mjeteve prej 2.000 € transferohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport (kodi i programit 644850).

Shuma e mjeteve prej 21,948.00 € do të bartet nga mjetet e mbetur (të lira) nga projektit që janë në finalizim, për realizimin e këtyre dy projekteve:

Kodi i projektit 88506 - Asfaltimi i rrugës "Ismail Qemajli", shuma e mjeteve 18,888.00 €;

Kodi i projektit 88514 - Asfaltimi i rrugës Bukosh-Taraxhë, shuma e mjeteve 3,060.00 €.

7. Të ndryshme.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- lidhur me rregullimin e lumit "Tërstenka", tha se prej shtëpisë së doktor Shabanit në gjatësi prej 1000 metrave ky lum nuk ka parmak, nuk i ka trotuaret e që është dashtë t'i ketë. Në fund tha se projekti për lumin "Tërstenka" ka mbetur i papërfunduar, prandaj kërkoi që të finalizohet projekti për lumin në fjalë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se disa herë e ka ngritë problemin e vendosjes së "policëve të shtrirë" nëpër lagje, pasi që në shumë lagje mungojnë "policët e


shtrirë”, edhe pse ka vozitje me shpejtësi të jashtëzakonshme nëpër ato lagje, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që të merren masa, të vlerësohet nga ekspertët se ku ka nevojë për vendosjen e “policëve të shtrirë”, në mënyrë që të pengohet zhvillimi i shpejtësisë së madhe e cila mund të jetë fatale përfundim i atyre lagjeve. Pastaj tha se në rrugën e shtruar me kubëza përgjatë lumit “Tërstenka” në të dy anët ka lëvizje të automjeteve, prandaj kërkoi që të merren masa për vendosjen e ndonjë pengese, me qëllim që të pengohet qarkullimi i automjeteve, përveç për banorët që banojnë në ato lagje. Në fund pasi që është përfundimi i mandatit të anëtarëve të KK-së, ai iu dëshiroi suksese të gjithë anëtarëve të KK-së.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të PDK-së i përgëzoi të gjithë anëtarët e KK-së për mandatin që po e përfundojmë. Po ashtu falënderoi për punë të suksesshme ish-kryesuesin Ferit Idrizi dhe kryesuesin aktual Habib Mustafa, si dhe një falënderim të veçantë e bëri edhe për kryetarin e komunës, i cili ka qenë shumë bashkëpunues me të gjithë.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- falënderoi të gjithë anëtarët e kuvendit, kryetarin e komunës dhe qeverinë lokale për punën e përbashkët dhe për sukseset e arritura. Po ashtu falënderoi përfaqësuesin e OSBE-së dhe mjetet e informimit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

Procesmbajtësi



Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa